## AKT THEMELIMI
## I POLICISË PRIVATE "GOGA" SH.P.K. FIER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MIRANDA XHEMALCE NOTERE TIRANE

Bazuar në ligjin 7512 dt: 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, etj.", unë Pëllumb Goga vendosa krijimin e shoqërisë private SHPK "Goga" polici private me kushtet që vijen :

Neni 1

Selia e e policisë private "GOGA" do të jetë në Fier. Ajo mund ta zgjeroj aktivitetin e saj duke hapur degë edhe në rrethe te tjera te vendit.

Neni 2

Kohë zgjatja e aktivitetit të saj do të jetë për një periudhe kohe mbi 10 vjet.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë se policise private "GOGA" eshte : Ruajtja e qetësisë publike, e personave juridik dhe fizik vendas e të huaj, si dhe ruajtja e objekteve dhe pronave te ndryshme te personave juridik dhe fizik vendas e të huaj.

Neni 4

Për fillimin e veprimtarise se vet ekonomike financiare shoqëria disponon një kapital themeltar prej 100.000 leke.

Neni 5

Administrator i policisë private "Goga" SHPK Fier do te jetë themeluesi i saj Pëllumb Goga. Ai ka të drejtë te punësoje çdo person që përmbush kushtet për tu veshur polic në bazë të kushteve të përcaktuara në kontratën e punës.

Neni 6

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe për çështjet që nuk rregullohen në kontratë zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës.

Neni 7

Të ardhurat qe do të sigurohen nga aktiviteti i shoqërise dhe zgjerimi i tij në përputhje me objektin e veprimtarise janë pronë e themeluesit te saj Pëllumb Goga.

Neni 8

Veprimet financiare me të tretët do të kryhen nëpërmjet bankës ku shoqëria "GOGA" do të ketë numër të saj llogarie.

Neni 9

Për mosmarrveshjet që mund të lindin midis themeluesit dhe personave të tretë fizik ose juridik do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast të kundërt në Gjykatë sipas statutit të shoqërisë,, ketij akti

themelimi dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Nemi 10

Shoqëria "Goga", polici private do të shpërndahet kur themeluesi i saj do të heqë dorë nga ushtrimi i aktivitetit privat, kur do të falimentoj dhe kur një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht me ligj.

Nemi 11

Shoqëria ka vulën e saj të rrumbullakët dhe siglen "GOGA".

Nemi 12

Aktiviteti i shoqërisë fillon me rregjistrimin e saj në person juridik pranë gjykatës së rrethit Tiranë.

T H E M E L U E S I

PELLUMB GOGA

Goga

REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R I A

T I R A N E

NR. 280 REP

NR. 135 KOL

V E R T E T I M

Sot në zyrën e noterisë Tiranë, para meje noterit u paraqit personalisht Pëllumb Goga, për identitetin e të cilit u sigurova nga letër njoftimi i tij personal, i cili kërkoi vërtetimin e aktit të themelimit të policisë private "GOGA" SHPK Fier të hartuar jashtë kësaj zyre me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, të cilin e nënshkroi para meje dhe unë noteria e vertetoj atë sipas ligjit.

N O T E R E

MIRANDA XHEMALCE
N O T E R E
TEL 262 84
T I R A N E

PULLE TAKSE
SHQIPERISE

# S T A T U T
## I POLICISË PRIVATE "GOGA" SHPK FIER

Neni 1

Policia private "GOGA" SHPK Fier në përputhje me aktin e themelimit dhe legjislacionin shqiptar, me këtë statut rregullon pozitën juridike te themeluesit, marrëdhëniet e tij me punonjësit dhe të tretët, te dhena me rëndesi për organizimin dhe objektin e shoqerise si dhe çështje te tjera që lidhen me punën e saj.

Neni 2

Policia private "Goga" krijohet me mjetet vetiake të themeluesit të saj me karakter premë private.

Neni 3

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj me emërtimin policia private "GOGA" SHPK Fier.

Neni 4

Selia e shoqërisë do të jetë në Fier, për sjo mund të hapë degë të aktivitetit të saj duke u shtrirë edhe në rrethe të tjera të vendi

Neni 5

Afati i vazhdimit të aktivitettit të policisë private "GOGA" ështe mbi 10 vjet.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se policise private "Goga" SHPK Fier do të jetë ruajtja e rendit dhe qetesisë publike, ruajtja e personave juridik dhe fizik, ruajtja e objekteve dhe personave te ndryshëm juridik dhe fizik.

Neni 7

Për te bërë të mundur ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë është derdhur kapitali themeltar prej 100.000 lekësh. Ky kapital depozitohet në bankë nga administrateri ku çelet nr. i llogarisë për shoqerisë.

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të parimeve të llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Neni 9

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas rritjes ekonomike të saj, te ardhurat do të sigurohen nëpërmjet veprimtarisë private të përcaktuar në përputhje me objektin e saj.

Neni 10

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta financimi për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të saj. Ajo disponon plotësisht mjetet e veta financiare, Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondi rezervë, nga fonde të tjera ose nga

shuma suplementare që mund të derdhë themeluesi i saj.

Neni 11

Organi vendimor i shoqërisë është administratori i cili vendos për të gjitha çështjet që merr në shqyrtim gjatë veprimtarisë së shoqërisë për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin ose pakësimin e kapitalit themeltar, për caktimin e drejtimeve themelore të veprimtarisë së shoqerisë, për emërimin e drejtorit të përgjithshëm dhe të antarve të asamblesë si organ këshillimor, për shkrirjen ose mbylljen e shoqërisë,etj. Administrator është Pëllumb Gega.

Veç sa më lartë administratori ka edhe këto kompetenca :

- Të përfaqsojë shoqërinë kundrejt të tretëve brenda caqeve të veprimtarisë së shoqërisë si dhe të veprojë në mardhënie me organet shtetrore në të gjitha rrethanat.
- Të miratojë planet e llogarisë pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Të miratojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë, të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve në shoqëri dhe pagat e tyre.

Neni 12

Administratori i policisë private përgjigjet për moskryerjen e funksionit me ndergjegje, për organizimin e punës dhe udhëheqjen e policisë. Ai përgjigjet materialisht për dëmin i cili shkaktohet nga ekzekutimi i vendimeve të cilat janë nxjerrë me propozimin e tij.

Neni 13

Gjithë fitimi i realizuar nga aktiviteti i policisë është pronë e administratorit të saj.

Neni 14

Organe të tjera që i shërbejnë mbarëvajtjes së veprimtarisë së shoqërisë janë asamblea e shoqërisë si organ këshillimor e zgjedhur nga administratori si dhe drejtori i përgjithshëm i cili përbën organin ekzekutiv.

Asamblea ka për detyrë ti bëjë propozim administratorit për të bërë ndryshime në program, në statut, për formën e organizimit si dhe të ndihmojë për zbatimin e vendimeve të marra.

Drejtori i përgjithshëm ka për detyrë kontrollin e zbatimit të detyrave, administron veprimtarinë e degëve me prokura ose sipas vendimit të administratorit, nënshkruan kontrata për llogari të shoqërisë me përjashtim të atyreqë varen nga vet administratori.

Neni 15

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë statut.

Neni 16

Punësimi i punonjësve në polici behet mbi bazën e kontratës së punës ku përcaktohet kushtet e mardhënieve të punës, koha e punës, puna e natës, puna jashtë kohës normale, puna në ditët e festave zyrtare dhe pushimit javor, paga e punës si dhe shpërblimet e tjera.

Neni 17

Veprimtaria e shoqërisë mbaron në afatin e përcaktuar në aktin e themelimit, këtë statut ose dhe më parë kur gjatë 2 viteve të njëpas një shme veprimtaria e saj rezulton jo rentabël; kur administratori i saj he noq derë nga aktiviteti ose kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht në legjislacion.

Neni 18

Kur shoqëria likujdohet administratori emëron komisionin e likujdimit i cili paraqet për miratim bilancin e likujdimit. Shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në këtë çast.

Neni 19

Ky statut hartohet në katër kopje me fuqi të barabartë secila për tu depozituar pranë organeve përkatëse shtetrore dhe një kopje për dokumentacionin bazë të shoqërisë.

T H E M E L U E S I
PELLUMB GOGA
Goga

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
T I R A N E

NR. 280 REP
NR. 135 KOL

V E R T E T I M

Sot në zyrën e noterisë Tiranë, para meje noterit u paraqit personalisht Pëllumb Goga, për identitetin e të cilit u sigurova nga letë njoftimi i tij, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili kërkoi vërtetimin e statutit të krijimit të policisë private "GOGA" SHPK Fier. Deklaroi se statuti është hartuar jashtë kësaj zyre me vullnet in e lirë dhe të plotë të tij, të cilin e nënshkroi para meje dhe unë